

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: S. G., M., S., D., A. dhe E. S. që të gjithë nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.415-3/2016 të datës 24.03.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre – avokatëve B. S., H. C., H. S. dhe F. Sh. që të gjithë nga Prizreni, me datë 01.04.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

## Të akuzuarit:

S. G. nga i ati A. dhe e ëma Z. e lindur S., i lindur më datë në fshatin Komuna Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, bojaxhi, i martuar, gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

M. S. nga i ati M. dhe e ëma Gj. e lindur G., i lindur më datë në fshatin Komuna Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, fasader, i pa martuar, gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

D. A. nga i ati H. dhe e ëma Gj. e lindur N. i lindur më datë në fshatin Komuna Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, automekanik – i pa punë, i pa martuar, gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

E. S. nga i ati N. dhe e ëma Sh. e lindur B., i lindur më datë në tani me banim në fshatin Komuna Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, automekanik – i pa punë, i pa martuar, gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTOR

Me datë 29.02.2016 – 02.03.2016 gjatë orëve të natës, në fshatin Komuna e Prizrenit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të akuzuarit bashkërisht ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit B. G., në atë mënyrë që e shfrytëzojnë momentin e volitshëm, orët e vona të natës me përdorimin e forcës thyejnë derën e depos – garazhës hynë brenda dhe nga aty marrin gjësende të vlefshme dhe atë: 4 (katër) disqe të gomave 19 coll për BMW, 2 (dy) fleksa të vegjël me ngjyrë të zezë, 1 (një) fleks i madhe me ngjyrë të kuqe, 1 (një) shvajcë aparat me ngjyrë të zezë, 1 (një) strugë të dorës me ngjyrë të kuqe, 1 (një) strugë gërryeseje ngjyrë të zezë, dy bateri të automjetit 65 amper dhe 100 amper, 2 (dy) burmashina, një

(një) shigë zege me ngjyrë të kuqe, 1 (një) cirkular i dorës, 1 (një) kos elektrike, 3 (tre) ako të mëdhenj dhe 2 (dy) të vogla, 2 (dy) zmadhues për muzikë, me ç'rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material të konsiderueshme.

**Kësodore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 46, 49, 50, 51, 73, 83 dhe nenit 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK ndaj të akuzuarve iu shqipton:

**- dënimin me burgim nën kufirin e paraparë me ligj e aplikoi – nenin 76 par.1 nën par.1.3 të KPK ashtu që:**

## G J Y K O N

- Të akuzuarin **S . G .** me dënim me kusht ashtu që vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale dhe

- me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 € (një mijë euro) në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.03.2016 deri më datë 01.04.2016, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të hiqet nga 20 €. Shuma e mbetur e dënimit me gjobë në lartësi prej 420 €, i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në aftin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 21 (njëzet e një) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

- Të akuzuarin **M . S .** me dënim me kusht ashtu që vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale dhe

- me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 € (një mijë euro) në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.03.2016 deri më datë 01.04.2016, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të hiqet nga 20 €. Shuma e mbetur e dënimit me gjobë në lartësi prej 420 €, i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në aftin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 21 (njëzet e një) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

- Të akuzuarin **D . A .** me dënim me kusht ashtu që vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale dhe

- me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 € (një mijë euro) në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.03.2016 deri më datë 01.04.2016 ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të hiqet nga 20 €. Shuma e mbetur e dënimit me gjobë në lartësi prej 420 €, i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në aftin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 21 (njëzet e një) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të akuzuarin E S me dënim me kusht, ashtu që vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitesh, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re panel dhe

- me dënim me gjobë në lartësi prej 1.000 € (një mijë euro) në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.03.2016 deri më datë 01.04.2016 ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të liqet nga 20 €. Shuma e mbetur e dënimit me gjobë në lartësi prej 420 €, i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimin me gjobë nuk ekzekutohet në aftin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 21 (njëzet e një) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

I dëmtuari B (N ) G nga fshati Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit obligohen në mënyrë solidare të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili prej tyre veç e veç shumën prej nga 50 € në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.415-3/2016 të datës 24.03.2016, kundër të akuzuarve: S: G, M S, D. A dhe E S, që të gjithë nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpallosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. Të akuzuarit pas konsultimit me mbrojtësit e tyre deklarojnë se nuk e kundërshtojnë asnjë provë në të cilën mbështetet aktakuza, andaj edhe në mënyrë vullnetare kanë pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohen.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në periudhën kohore prej datës 29.02.2016 e gjer më 02.03.2016 në orët e vona të natës, në fshatin Komuna e Prizrenit, të akuzuarit S: G, M S, D. A dhe E S, duke vepruar bashkarisht e shfrytëzojnë momentin e volitshëm mos prezencën e dëmtuarit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete, shkojnë në vendin kritik afrohen depos së dëmtuarit B G, duke e përdorë forcën e thyejnë derën e depos dhe depërtojnë brenda, nga aty marrin gjësende të vlefshme dhe atë: 4 (katër) disqe të gomave 19 coll për BMW, 2 (dy) fleksa të vegjël me ngjyrë të zezë, 1 (një) fleks i madhe me ngjyrë të kuqe, 1 (një) shvajc aparat me ngjyrë të zezë, 1 (një) strugë të dorës me ngjyrë të kuqe, 1 (një) strugë gërryeseje ngjyrë të zezë, dy bateri të automjetit 65 amper dhe 100 amper, 2 (dy) burmashina, një stig zege me ngjyrë të kuqe, 1 (një) cercullar i dorës, 1 (një) kos elektrike, 3 (tre) ako të mëdhenj dhe 2 (dy) të vogla, 2 (dy) zmadhues për muzikë, me ç'rast të dëmtuarit i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm material.

Gjykata para se të hap senacën fillestare -- paraprakisht bëri shiqimin e shkresave të lëndës, analizës së deponimeve të akuzuarve dhe dëmtuarit B G , provave material, përmbledhjen e dosjes së forenzikës -- lista e dëshmimeve si edhe gjatë seancës fillestare ka ardhë në përfundim se të akuzuarit S G , M S , D A dhe E S , të dëmtuarin e kanë bashkëfshatar. Të njëjtit para se të kryejnë veprën penale të vjedhjes, ditën kritike janë marrë vesh, janë pregaditur, ashtu që me veturën e akuzuarit S G të markës "Pikap", zgjedhin kohën e volitshme, i paisur me mjete të përshtatshme për eliminimin e pengeçave e thyejnë hapsirat e mbyllura, duke e përdorë mjete të përshtatshme për hapjen e derës, hyjnë brenda në depo pronë e dëmtuarit B G dhe nga aty marrin gjësende me vlerë dhe atë vegal pune, bateri dhe disqe të gomave, të cilat i takojnë dë dëmtuar, me ç'rast të njëjtit kanë shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme. Të akuzuarit i kanë ndërmarre të gjitha këto veprime me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj, nga e cila rezulton se veprimet e këtilla kanë kryer me dashje direkte, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e veta, për pasojat dhe kanë dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarve formohen elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimit vullnetar i fajësisë nga e akuzuarve për veprimet e tyre të përshkruar si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohen dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se të akuzuarit prej fillimit të hetimeve kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i kanë kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga ana e akuzuarve është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe kanë ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarve formohen elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarit morri parasysh faktin se kanë pranuar fajësinë dhe kanë tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarve gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tyre për kryerjen e veprës penale, kthimin e një pjese të sendeve të dëmtuarit, janë të gjendjes së dobët ekonomike, gjer më tani nuk ka kryer vepra penale, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata iu shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimin i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla, me bindje se janë proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor.


Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.


Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.637/2016 të datës 01.04.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**



**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**



**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.